

MS/M/S



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale

Nr. 6031, datë 31.12.2019

Ministria e Financave dhe
Ekonomisë

Nr. 24250/1, datë 31.12.2019

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 808, datë 31.12.2019

“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE, NË ZBATIM TË PROGRAMIT TË DALJES NGA SKEMA
E NDIHMËS EKONOMIKE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” dhe të pikës 24 të vendimit nr.882, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”,

URDHËROJMË

1. Miratimin e planit të masave në zbatim të programit të daljes nga skema e ndihmës ekonomike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në planin e masave dhe institucionet në varësi të tyre, për zbatimin e aktiviteteve të këtij plani, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.
3. Ngarkohen për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri struktura përgjegjëse për ndihmën ekonomike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe struktura përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Ogerta MANASTIRLIU

MINISTRI I FINANCEVE
DHE EKONOMISË

Anila DENAJ